



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Nr. 972 Prot

Tiranë më 20 / 01 /2026

U R D H Ë R

Nr. 90 prot. më 20.01.2026

Mbi zbatimin e procedurave për dhënien e gradave të punonjësve të policisë së burgjeve

*Të gjithë IEVP-ve
Drejtorisë së Policisë së Burgjeve
Drejtorisë së Burimeve Njerzore, Shërbimeve dhe Projekteve
Komisionit, Këtu*

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2020 "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar, Kreu IV "Gradat në Policinë e Burgjeve", nenet 36 e në vijim; të Rregullores "Për Personelin e Policisë së Burgjeve", miratuar me VKM Nr.403, datë 09.06.2022, Kreu IV, nenet 24 dhe në vijim;

Me qëllim, plotësimin e vendeve të lira dhe dhënien e gradave punonjësve të rolit bazë dhe të mesëm të Policisë së Burgjeve,

U R D H Ë R O J :

1. Drejtoria e Burimeve Njerzore, Shërbimeve dhe Projekteve, të evidentojë në të gjitha IEVP-të dhe në DPB, numrin e funksioneve të lira për gradat Kryeinspektor; Nënkomisar, Komisar dhe Kryekomisar, Drejtues.
2. Të gjithë IEVP-të të bëjnë njoftimin për plotësimin e vendeve të lira, në rolin bazë dhe të mesëm të policisë së burgjeve, sipas gradave përkatëse, duke shpallur kriteret përkatëse për çdo gradë dhe vendet e lira, dokumentacionin e parashikuar dhe afatin e aplikimit.¹ Njoftimi të bëhet me datën **22.01.2026**
3. Periudha e aplikimit do të jetë **data 22.01.2026 deri më 02.03.2026**.
4. Drejtoritë e IEVP-ve të bëjnë regjistrimin e punonjësve për konkurim, bazuar në kërkesat me shkrim, të protokolluara dhe pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të punës të dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme deri më datë **28.02.2026**, me postë. Lista në exel, të dërgohet edhe me email:
 - Vlerësim pune të punonjësit sipas formatit bashkëlidhur
 - Propozim të drejtorisë së IEVP, të arsyetuar, duke përshkruar plotësimin e kriterëve.
 - Kërkesë individuale të punonjësit që aplikon për gradë

- Listë përmbledhëse të të gjithë aplikantëve sipas gradave që aplikojnë.
- 5. Drejtoritë e IEVP_ve, përpara se të bëjnë njoftimin e punonjësve të policisë në IEVP për aplikim për ngritje në gradë, të kenë përfunduar gjithë sistemimin e punonjësve me gradat aktuale, sipas pozicioneve që përputhen gradë funksion (neni 38 i Ligjit Nr.80/2020).
- 6. Drejtoritë e IEVP-ve të bëjnë njoftimin me shkrim të gjithë aplikantëve që nuk plotësojnë kriteret për të aplikuar dhe të trajtojnë të gjitha ankesat, duke njoftuar edhe DPB.
- 7. Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve verifikon dokumentacionin brenda 20 ditëve nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe listat e konkurrentëve ja vë në dispozicion Komisionit të Vlerësimit me protokoll.
- 8. Komisioni i vlerësimit për dhëjen e gradave të bëjë testimin me shkrim dhe vlerësimin e konkurrentëve sipas gradave në njw urdhwr tw dytw:
- 9. Komisioni vlerësimit për dhëjen e gradave të bëjë vlerësimin e konkurrentëve, sipas nenit 32 të Rregullores së Personelit të Policisë së Burgjeve sipas gradave nga data 10 ditë pas vlerësimit të testit me shkrim për secilën gradë.
- 10. Qendra e Trajnimit të organizojë trajnimin e kandidatëve të shpallur fitues brenda një muaj nga përfundimi i procesit të vlerësimit.

11. Kriteret për fitimin e gradës²:

Punonjësi i Policisë së Burgjeve, për fitimin e gradës së radhës, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a. *Të ketë vlerësim vjetor pozitiv të punës gjatë kohës së qëndrimit në gradë;*
- b. *Të përmbushë kriteret për pozicionin e punës, sipas fushës së shërbimit;*
- c. *Të mos ketë masë disiplinore në fuqi për shtyrjen e afatit të ngritjes në gradë, sipas parashikimeve në legjislacionin për Policinë e Burgjeve;*
- d. *Të ketë përfunduar me sukses trajnimin profesional për marrjen e gradës së radhës;*
- e. *Të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë, sipas afateve të mëposhtme:*
 - *Nga Inspektor në Kryeinspektor 5 vjet*
 - *Nga Kryeinspektor në Nënkomisar 5 vjet*
 - *Nga Nënkomisar në Komisdar 3 vjet*
 - *Nga Komisar në Kryekomisar 4 vjet*

12. Testimi për ngritje në gradë³:

- *Për ngritje nga grada Inspektor në Kryekomisar, faza e parë e përzgjedhjes është provimi me shkrim, për të testuar njohuritë teknike të kandidatit në fushën e legjislacionit në fuqi për Policinë e Burgjeve, të legjislacionit penal, të legjislacionit bazë administrative dhe aftësive bazë të drejtimit.*

² Neni 25 i Rregullores së Personelit të Policisë së Burgjeve miratuar me VKM Nr 403 datë 09.06.2022

- *Kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit përkatës nuk mund të jetë më i ulët se 70% e vlerës së përgjithshme të pikëve të testimit.*
- *Rezultatet e testimit me shkrim përbëjnë 50% të rezultatit të përgjithshëm të vlerësimit të kandidatit për fitimin e gradës së radhës.*
- *Pas testimit me shkrim, kandidatët vlerësohen për:*
 - a. *Aftësitë komunikuese*
 - b. *Aftësitë menaxhuese dhe drejtuese*
 - c. *Aftësitë vendimmarrëse*
 - d. *Aftësitë gjyqësore*
 - e. *Motivimi personal*
 - f. *Legjislacioni dhe instrumentet ndërkombëtare të sistemit të burgjeve*
- *Kufiri minimal për kalimin me sukses të vlerësimit nuk mund të jetë më i ulët se 70%. Rezultatet e testimit profesional janë 50% e vlerësimit të përgjithshëm.*

13. Drejtori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Projekteve të bëjë propozimet për plotësimin e vendeve të lira dhe dhënen e gradave tek autoritetet **pas përfundimit të procesit të vlerësimit**
14. Ndjek zbatimin e këtij Urdhëri, Drejtori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Projekteve
15. Përgjigjet për zbatimin e këtij Urdhëri, Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve, dhe Projekteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

KLEVIS QOSE

